



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 174 dt.26.08.1994

**MBI**  
**DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN KORRIK 1994**

Në zbatim të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën ekonomike dhe përkujdesjen shoqërore”, V.K.M. Nr.622, dt.31.12.1993 “Për dhënie e ndihmës ekonomike”, Udhëzimi Nr.9, dt.23.02.1994 të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, V.K.M. Nr.138, dt.31.03.1994 “Për kompesimin e shpenzimeve të energjisë elektrike”, V.K.M. Nr.307, dt.24.05.1994 “Për shërbimet e përkujdesit shoqëror” gërma.A pikat.1, 2 dhe 6, Këshilli Bashkiak, i mbledhur sot më dt.26.08.1994, pasi shqyrtoi edhe relacionin e Seksionit të Mbrojtjes Shoqërore,

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin korrik gjithsej 11.951 familje me një fond prej 32.7 milion lekë, nga të cilat :
  - Me ndihmë të plotë 10.931 familje me një fond prej 31.5 milion lekë
  - Me ndihmë të pjesshme 1.020 familje me një fond prej 1.2 milion lekë.

E detajuar sipas njësive, pasqyrave bashkangjitur.

2. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike 73 familje.

Të ndara sipas njësive pasqyra e bashkangjitur dhe arsytet përkatëse.

3. Të miratuara për ndihmë ekonomike si raste të veçanta :

- Asllan Çullhaj, ndihmë e pjesshme, llogaritja me kuotën maksimale, Nj.A.1
- Besim Liman Sala, ndihmë e pjesshme, llogaritja me kuotë max, Nj.A.4
- Fiqirete Hysni Bushi, familje me një anëtarë, Nj.A.6, ndihmë ekonomike e plotë
- Pranvera Etem Çobaj, familje me një anëtarë Nj.A.6, ndihmë ekonomike e plotë
- Pranvera Hajdari, familje me një anëtarë, Nj.A.6, ndihmë ekonomike e plotë
- Fatime Bibaa, familje me një anëtarë, Nj.A.6, ndihmë ekonomike e plotë
- Kudrete Çeka, familje me një anëtarë, Nj.A.7, ndihmë ekonomike e plotë
- Dhurata Hoxholli, familje me një anëtarë, Nj.A.9, ndihmë ekonomike e plotë
- Fatime Çomo, familje me një anëtarë, Nj.A.9, ndihmë ekonomike e plotë
- Azize Zajmi, familje me një anëtarë, Nj.A.10, ndihmë ekonomike e plotë

4. Për individët e paaftë, grupi 6 të invaliditetit :  
Vihet në dispozicion fondi dy – mujorë prej 2.9 milion lekë i cili do të përballojë 1.103 persona.

5. Për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi ngarkohen :  
Seksioni i Mbrojtjes Shoqërore në Bashki,  
administratorët, pagatorët dhe arshivistët e njësive administrative.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**